

VENDIM
Nr.872, datë 12.8.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË ÇOROVODË, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Çorovodë të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Çorovodë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.406, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Çorovodë, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Çorovodë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Çorovodë
nr.1

Lidhja

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i pronës
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në përdorim
8-18	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
22-23,25-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
31,36,37,42,51	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
65-614	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
615	Varreza publike	Në pronësi
619-622	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
623-627	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
785,788	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
789	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi